



REPUBLIKA E MAQEDONISË  
MINISTRIA E EKONOMISË

Në pajtim me Programin për konkurrencë, inovacion dhe sipërmarrësi për vitin 2016 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 2/2016), Ministria e Ekonomisë shpall:

**THIRRJE PUBLIKE**  
**për subvencionimin e ndërmarrjeve për zbatim dhe çertifikim të HALLALL sistemit**

**1. Lëndë e thirrjes publike** është subvencionimi i ndërmarrjeve për zbatim dhe çertifikim të HALLALL sistemit, përmes kofinansimit të 70% të shpenzimeve të dëshmuara për këtë qëllim, por jo më shumë se 200.000 denarë veçmas për secilin subjekt afarist-kërkues të mjeteve.

Në pajtim me Programin për konkurrencë, inovacion dhe sipërmarrësi për vitin 2016 pjesa II, A. Përkrahja dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, masa 5 – Përkrahja financiare për zbatim dhe çertifikim të HALLALL sistemit („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr 2/2016) janë të parapara mjete në vlerë të përgjithshme prej 1.800.000 denarë.

**2. Të drejtë për pjesëmarrje në thirrjen publike kanë** të gjitha ndërmarrjet aktive të cilat i plotësojnë këto kushte:

- Punë prej më së paku gjashtë muaj para shpalljes së thirrjes publike (*regjistrimi në regjistrin tregtar*);
- Të kenë seli afariste në teritorin e Republikës së Maqedonisë;
- Të kenë të shlyera obligimet ndaj shtetit dhe të punësuarve.

Këto subvencione **nuk janë të dedikuara** për :

- Ndërmarrjet ndaj të cilave është ngritur procedura e falimentimit apo e likuidimit.
- Ndërmarrjet të cilët kanë qenë të subvencionuara për zbatim dhe çertifikim të HALAL sistemit në vitin 2014 dhe 2015.

Në rast se ndërmarrja e cila aplikon për kofinansim të shpenzimeve në bazë të kësaj mase, ndërpret ushtrimin e veprimtarisë para përfundimit të 1 (një) viti nga data e shpalljes së thirrjes publike (përveç në rast të vdekjes ose paaftësisë së përhershme), në atë rast personi- themelues i ndërmarrjes ka obligim të kthen 80% prej mjeteve financiare të ndara në bazë të qëllimeve të parapara në periudhë prej 12 muajve.

**3. Dokumentet e nevojshme për paraqitje:**

- Formulari i plotësuar „**Kërkesë – HALLALL 2016**“ (mund të meret nga arkiva ose ueb faqja e Ministrisë së Ekonomisë [www.economy.gov.mk](http://www.economy.gov.mk));
- Formulari i plotësuar „**Deklaratë – 2016**“, e vërtetuar te noteri ( Deklarata nga kërkuesi për ndarjen e ndihmës shtetërore, mund të meret nga arkiva ose ueb faqja e Ministrisë së Ekonomisë [www.economy.gov.mk](http://www.economy.gov.mk));

- Gjendja rrjedhëse nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë, jo më e vjetër se 2 (dy) muaj;
- Vërtetim për tatime dhe kontribute të paguara lëshuar nga Drejtoria për të Hyra Publike e Republikës së Maqedonisë, jo më e vjetër se 2 (dy) muaj;
- Marrëveshje për zbatim të HALLALL sistemit ndërmjet kërkuesit dhe konsulentit të autorizuar/shtëpia konsulente e lidhur gjatë vitit 2015 ose 2016 ( data e Marrëveshjes të jetë para datës së Çertifikatës së lëshuar), e vërteuar te noteri;
- Marrëveshje për certifikim të HALLALL sistemit ndërmjet kërkuesit dhe Agjencionit për HALLALL standard të Maqedonisë, e lidhur gjatë vitit 2015 ose 2016 ( data e Marrëveshjes të jetë para datës së Çertifikatës së lëshuar), e vërteuar te noteri;
- Çertifikatë për HALLALL sistem nga Agjensioni për HALLALL standard i Maqedonisë, lëshuar gjatë vitit 2015 ose 2016;
- Faturë për shpenzimet e realizuara për zbatim të HALLALL sistemit nga konsulenti i autorizuar/shtëpia konsulente;
- Faturë për shpenzimet e realizuara për certifikim të HALLALL sistemit nga Agjencionit për HALLALL standard të Maqedonisë;
- Çertifikatë nga banka në të cilin shihet që aplikuesi në tërësi i ka shlyer detyrimet për shpenzimet e realizuara nga faturat e dorëzuara;
- Fletpagesë në vlerë prej 300,00 denarë (Qëllimi i pagesës:pagesë për taksa administrative, Pranues:Buxheti i RM, Llogaria e trezorit:100000000063095, Llogaria:840\_\_(varësisht nga komuna) 06116, Kodi i të hyrave dhe programa:72593000).

**Dokumentacioni i lartpërmendur dorëzohet në origjinal ose kopje.**

**Nëse dokumentacioni dorëzohet kopje, besueshmërinë e e dokumentacionit aplikuesi i kërkesës e vërteton me nënshkrim dhe vulë të vetën në secilën faqe të kërkesës.**

Kërkesat për subvencionim i shqyrton Komisioni i formuar nga Ministri i Ekonomisë.

Zgjedhja e aplikuesve të cilët i plotësojnë kushtet të parapara me thirrjen publike do të bëhet në përputhje me parimin „I pari vjen i pari shërbehet”, respektivisht sipas dorëzimit të aplikacionit, deri në harxhimin e mjeteve në dispozicion.

Një aplikues mund të shfrytëzojë subvencion vetëm një herë për këtë thirrje publike.

Thirrja publike është shpallur në ueb faqen e Ministrisë së ekonomisë [www.economy.gov.mk](http://www.economy.gov.mk) dhe në [www.konkurentnost.mk](http://www.konkurentnost.mk)

Kërkesat me dokumentacion të kompletuar dorëzohen në Arkivin e Ministrisë së Ekonomisë, rr."Jurij Gagarin" nr.15, Shkup, **deri në 31.05.2016.**

tel: (02) 3093 525; 3093 508 [www.economy.gov.mk](http://www.economy.gov.mk).